



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 09.12.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 23.11.2021, të parashtruar nga **Operatorët Ekonomik: 1.NSHT “Viktory Com” dhe 2. Marisa SH.P.K. & “Company Murseli”sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkallëve në Çabrat”, me Nr. të Prok: 632-21-7298-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-127-521, nxjerr:

### V E N D I M

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi i dt.03.12.2021, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të dt.23.11.2021, të parashtruar nga **Operatorët Ekonomik: 1.NSHT “Viktory Com” dhe 2. Marisa SH.P.K. & “Company Murseli”sh.p.k.**, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shkallëve në Çabrat”, me Nr. të Prok: 632-21-4644-5-2-1, **dhe hyn në fuqi vendimi i sotëm dt.09.12.2021.**
2. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Grupit të **Operatorëve Ekonomik Marisa SH.P.K. & “Company Murseli”sh.p.k.**, e dt. 23.11.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i urës për këmbësor dhe biçikleta mbi Lumin Erenik , me Nr. të Prok: 632-21-4644-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-076-521, kundër **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, të datës 19.11.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
3. **Refuzohet** si e pabazuar, kërkesa për rishqyrtim e **Operatorit Ekonomik NSHT “Viktory Com”** e dt. 23.11.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i

shkallëve në Çabrat”, me Nr. të Prok: 632-21-7298-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-127-521, kundër Njoftimit MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 19.11.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

4. Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES i publikuar me datë: 19.11.2021;
5. Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthejë në ri-vlerësim.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

### **A r s y e t i m**

- I. **Operatorët Ekonomik: 1.NSHT “Viktory Com” dhe 2. Marisa SH.P.K. & “Company Murseli”sh.p.k.**, me datë 23.11.2021, kanë parashtruar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shkallëve në Çabrat”, me Nr. të Prok: 632-21-7298-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-21-127-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 09.12.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

#### **I- Përgjigje për Operatorin Ekonomik NSHT “Viktory Com”:**

Kërkesa juaj për rishqyrtim është e pabazuar, sepse: me dt.01.11.2021 janë kërkuar nga ju sqarime shtesë sipas nenit 72, të LPP-së, dhe ju nuk i jeni përgjigjur kërkesës së Autoritetit kontraktues, prandaj është vazhduar me Operatorin tjetër ekonomik me radhë .

#### **II- Përgjigje për Grupin e Operatorëve Ekonomik “Marisa” SH.P.K. & “Murseli Company” shpk :**

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 09.12.2021, ka konstatuar se pretendimet e Grupit të Operatorëve ekonomik “Marisa” SH.P.K. & “Murseli Company” shpk, janë pjesërisht të bazuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunë